

Franz Kafka

Amerika
ose
I zhdukuri

roman

Përktheu: Raif Hasani

Botimet
DRITAN
Tirana

Titulli i origjinalit: **“Amerika - Der Verschollene”, Franz Kafka**

(Përkthyer nga botimi i bërë sipas gjendjes së fundit të dorëshkimit të Kafkës)

© **Për Botimin në Gjuhën Shqipe: Botimet DRITAN**

Redaktoi: Vladimir Bako

All rights reserved. No part of this publication may be reproduced or transmitted, in any form or by any means, without permission of the publishers.

Të gjitha të drejtat e riprodhimit, përshtatjes janë të rezervuara për botuesin; çdo riprodhim i pjesshëm i çfarëdoshëm i këtij libri në çdo rrugë qoftë, veçanërisht përmes fotokopjimit apo mikrofilmit, është absolutisht i ndaluar pa autorizimin me shkrim të botuesit.

ISBN: 978-9928-184-39-9

Dritan Editions - Tirana
Bulevardi “Bajram Curri”, Aviacioni i Ri, 7/51,
Tirana, Albania.
Tel.&Fax: 00355 4 222 40 44
Tel.: 00355 4 224 57 09
E-mail: botimetdritan@gmail.com

AMERIKA

OSE

I ZHDUKURI

PARATHËNIE

Dy romanet e pambaruar të Kafkës, të titulluar “Procesi” dhe “Kështjella”, ishin botuar përpara vitit 1927, kur Maks Brodi nxori në dritë romanin e tretë, po që, në të vërtetë, ishte i pari për nga radha e të shkruarit, të cilin e titulloi “Amerika” (në gjermanisht: *Amerika*). Që nga ajo kohë dhe deri në ditët e sotme të gjitha botimet e romanit në gjuhën origjinale, ashtu sikurse edhe ato të përkthyerat, madje edhe të gjitha përshtatjet kinematografike, ruajtën për çdo rast këtë titull. Por asnjëherë, dihet, autori nuk e pati titulluar kështu veprën e tij të parë. Sipas Maks Brodit, autori vetëm sa kishte folur diçka për “romanin e tij amerikan”. Në fak, më vonë ai kishte përdorur për titull atë të kapitullit të parë, “*Makinisti*” (këtë pjesë Kafka e botoi veçmas në një revistë më 1913), me qëllim që kjo të tregonte vazhdimin dhe të tërën, ndonëse personazhet e “*Makinistit*” nuk janë përmendur më në kapitujt e tjerë. Po më vonë, Kafka kishte ndërruar mendim dhe e titulloi librin “*I zhdukuri*”, në gjermanisht: *Der Verschollene*, një emërtim që përdoret shpesh, për shembull kur thuhet për ushtarakët “figuron i zhdukur” ose edhe për çdo person në përgjithësi, për të cilin nuk kemi asnjë të dhënë, për dikë që ka humbur çdo gjurmë dhe që ka arsye të besohet se ka vdekur.

Në rast se ky botim i romanit të ri të Kafkës i ka kthyer librit si titull të dytë titullin e tij të vërtetë, atë që kishte zgjedhur autori,

“I zhdukuri”, kjo nuk përbën veçse një të drejtë. Pra, gjithsesi, mund të themi se u vlerësua ajo çka nuk mund të fshihej as nga emërtimi i huajtur për mbi gjashtëmbëdhjetë vjet me radhë “*Amerika*” dhe që përbënte një titull apokrif (jo autentik). Ndaj është më e arsyeshme që të bashkohen të dy titujt, ai i Maks Brodit dhe ai i zgjedhur nga Franc Kafka.

Ky titull i dyfishtë reflektohet mjaft mirë në roman: ai shpreh më qartë problemet e vërteta që shtrohen dhe ndriçon një numër çështjesh, të cilave u jepet shpesh përgjigje e gabuar nga kritika... Po, me qëllim që ky titull të flasë edhe më mirë ende, e pamë të arsyeshme që kësaj *Amerike të Karlit* t’i jepnim emrin e saj gjerman¹; kështu, që në fillim do të vinim në dukje se këtu nuk është fjala për Amerikën e vërtetë, po për imazhin e saj të vështruar gjetskë, në Gjermani, në Evropën Qendrore. Aq më e dukshme bëhet kjo nga germa “K” dhe tingëllimi i saj, sikurse te Kafka ose heroi i tij Karli; ose si te heroi i romanit tjetër, “*Procesi*”, Jozef K.; apo edhe si K te “*Kështjella*”. Kjo Amerikë në fjalë është shënuar dhe shënon inicialin e autorit, i cili tashmë do të bëhej simboli i romancierit të ardhshëm.

Pra, tani: “*Amerika ose I zhdukuri*”. Në këtë formë ky titull nxjerr në pah tri sërë pyetjesh që shtron romani dhe që dallohen thjesht gjatë leximit. *Cila Amerikë? Ç’është ky vend, ç’është kjo botë njerëzore? Cila “zhdukje”? Si përshkruhet kjo, si shkruhet? Dhe më në fund: Cili është Kafka? Është i tërë Kafka atje; po Karli, është edhe ky tashmë një K?*

Cila Amerikë?

Qysh në rreshtat e parë, Kafka na jep një hollësi shumë të rëndësishme, sikur të dojë ta paralajmërojë lexuesin se, së paku,

¹ Në shqip, sikurse edhe në gjermanisht, emërtimi i Amerikës nga ana grafike shkruhet me “K”.

Amerika e vet nuk është si Amerika e vërtetë. Mbi anijen që hyn në portin e Nju Jorkut, Karl Rosmani mbetet i mahnitur përpara Statujës së famshme të Lirisë. Po këtij vegimi, ëndërr për miliona kandidatë për emigrues që përpara dhjetëra vitesh, këtij monumenti, pa dyshim më të përmendurit se të gjithë të tjerët e kësaj natyre në botë, Kafka i tjetëron pamjen me një lloj “*kolitjeje*”, e cila bën efektin e një shtupe që zë vrimën: në vend që të *ndrisë botën* sikurse mendon për të çdo njeri, Statuja e Lirisë tregohet sikur vringëllin një shpatë!

Dorëshkrimi nuk lë asnjë shteg që të krijohet ndonjë gabim i qëllimshëm: kjo gjë nuk mund të pranohet edhe nga fakti i thjeshtë se dihej fama e statujës ndërkohë që teksti u rishikua edhe një herë për botim në vitin 1913. Në të vërtetë, në dorëshkrimet, në mbarim të paragrafit të parë, lexohet edhe kjo fjali, e cila më pas u hoq, ngaqë, pa dyshim, kishte më shumë domethënie se sa duhej: “*Ai ngriti sytë në drejtim të saj dhe i mohoi vetes se kishte mësuar që më parë diçka rreth saj.*”

Shmangia nga realiteti, pra, duket qartë. Fjalja e hequr që sapo cituam i drejtohej në njëfarë mënyre lexuesit, në këtë formë ajo e ruan fuqinë e vet: Amerika, mbi të cilën zbarkojmë së bashku me Karlin, nuk i përshtatet origjinalit dhe nuk dëshiron që t’i përshtatet. Liria ka marrë pa të drejtë atributin që tradicionalisht i përket një kategorie tjetër, është fjala për Drejtësinë; ky është një “montim”, kuptimin e të cilit do ta sqarojmë më tutje. Por ajo çka bie në sy dhe bëhet e qartë që në fillim, lidhet me gjestin mohues të autorit: ai mohon dhe na fton që të mohojmë “atë që kemi mësuar më parë” për këtë vend ku po zbarkon heroji ynë.

Tashmë, për të kuptuar se çdo të thotë fjala “*Amerika*”, duhet të mundohemi e të dëgjojmë sesi tingëllonte dikur ky emër në Botën e Vjetër, nga Irlanda në Sicili e në Evropën Qendrore. Më 1912, sikurse gjatë gjithë shekullit XIX, mbretëronte himnizimi vajtues ose i egër që i bëhej Lirisë, lirive qytetare, emancipimit real, mundësisë që të gjithë të kishin njëfarë prosperiteti

material, ngritje shoqërore, “pursuit of happiness”². “Evropa e vjetër”, e penguar nga një sërë shtypjesh dhe shfrytëzimesh, Evropa gjithnjë në gjendje lufte dhe shumë e populluar tashmë, nën ritmin e luftërave dhe të paqeve, revolucioneve dhe restaurimeve, krijonte “ëndrrën amerikane” fort këmbëngulëse dhe shumë therëse. Në gjuhën gjermane kjo ëndërr e Amerikës kristalizohet me një shprehje të sajuar më 1903 nga një farë Ludvig Maks Goldberger, një i porsakthyer nga Shtetet e Bashkuara: *das Land der unbegrenzten Möglichkeiten*, “vendi i mundësive të pakufishme”. Kjo formulë bëri bujë dhe mbeti proverbiale deri në ditët tona. “Romani amerikan” i Kafkës, në një kuptim është njëfarë kompensuesi i kësaj “ëndrre evropiane” ose më saktë i kësaj formule proverbiale. “Amerika” tregon një mit, ndërsa “I zhdokuri” tregon realitetin. Po le ta themi që në fillim, Kafka as që ka ndër mend të denoncojë mitin amerikan: kjo sipërmarrje për atë kohë do të ishte banale, nga ana tjetër, nuk ishte kjo gjë që i interesonte autorit. Përtej Amerikës reale e përtej vetë mitit, ishte esenca e këtij të fundit që e magjepsi, ishte ideja e “mundësive të pakufishme”. Pra, autori i shmanget Amerikës reale, duke i bërë lëshime mitit dhe veçon nga miti atë që mund të përbëjë një lloj modeli *heuristik* (zbulues) të atyre lloj mundësish, që kishin pretendimin të ishin “të pakufishme”, që i afroreshin lirisë njerëzore – asaj Lirie, alegoria e së cilës është përcaktuar që në faqen e parë; dhe ku autori ngul një shpatë.

Nëse e kuptojmë që Amerika e Kafkës është mitike dhe jo reale, do të kursenim mjaft pyetje të tepërta;... le të kujtojmë për ilustrim qytetet Batërford ose Ramses, të cilat as që ekzistojnë, apo Friskon të vendosur në Lindje, po ashtu le të sjellim në mendje një grumbull hollësirash që nuk i përgjigjen së vërtetës dhe që i ngacmojnë dhe i bëjnë të mërmërisin kafkologët, duke nisur me varkat që zbarkojnë pasagjerët në Nju Jork e deri hollësitë në metronë e Klejtonit... Në fakt, këto nuk janë as

² Pursuit of happiness – vazhdë, pasojë e lumturisë (fjalë anglisht)

gabime të rëndësisë që ia vlen për t'i korrigjuar, as simbole që meritojnë interpretime; komentet asnjëherë nuk kanë qenë më të sakta sesa në rastet kur i kanë kaluar në heshtje këto hollësi, (si, për shembull hollësia e njohur që në vendin e dollarit Karli llogaritë i bën në “çerek të livrës”, ose që numëron “shilingat” e veta, “monedhë amerikane”, siç ndërhyr për të saktësuar Kafka, po që në tekst shkruhet me një ortografi si në Austri!).

Në mitin e Amerikës, më pas, Kafka do të ruajë dhe mund të themi se do të privilegjojë atë që shkon me kuptimin e *së pakufishmes*. Është fjala këtu në radhë të parë për gjigantizmin, përmasat e të cilit i shpie në një mënyrë gati qesharake deri në kufijtë e ireales: le të përmendim disa detaje duke filluar që nga zyra “me rregullator” e ungjit Jakob (të gjitha dosjet e presidentit të Shteteve të Bashkuara do të sistemoheshin), apo më tej ashensorët e shtëpisë së tij (ku mbahej edhe një vagon treni) e deri te Teatri i Oklahomas (ku vetëm “zyra e rekrutimit nr. 10” ka, veç të tjerash, dy orkestra që përbehen nga qindra ekzekutues), duke kaluar akoma më tej në pesë mijë dhomat e Hotelit “Oksidental”, apo nëpër rrugët, ku (më 1912! ...) kamionët lëviznin mbi pesë radhë në të njëjtin drejtim!... Disa herë ky ekzagjerim ka dekurajuar edhe botuesit më të dëgjuar... duke lënë Nju Jorkun, pasi kalon kodrinat që dominojnë (sic) qytetin dhe portin, Karli admiron urën që e lidh këtë qytet me... Bostonin! Këto qindra kilometra ishin diçka e tepruar për Maks Brodin, prandaj ai korrigjon, duke këmbyer Bostonin me Bruklinin.

Për të shkuar në kuptimin e *së pakufishmes* Kafka vë në lojë mitin kundër realitetit, madje edhe e tepron këtë deri në përmasat e qesharakes. Nga ana tjetër, ai është edhe kundër tipareve të Amerikës që ka krijuar vetë, tipare që nuk pyesin aspak për realitetin dhe mitin së bashku. Kështu, në Nju Jorkun e Kafkës nuk ka hebrenj, as zezakë në Shtetet e tij të Bashkuara dhe një gjë e tillë, siç është vënë në dukje shpesh, është kundër mitit po aq sa

edhe kundër realitetit. Megjithëkëtë, Kafka e mbështet fort idenë e famshme të “melting pot-it”³ amerikan, madje e shfrytëzon këtë pakëz si tepër: Karl Rosmani e quan veten “gjerman” dhe “nga Praga” (sikur ta kishte thënë një gjë të tillë për veten), Shubali është rumun, Delamarshi francez, Robinsoni irlandez, kryekuzhinierja austriake, Tereza nga Pomerania, portieri Feodor sllav etj. Ky kozmopolitizëm shtrihet madje jo vetëm mbi personat, por edhe nëpër institucione si hoteli “Oksidental” që mban një emër frëng. Po pikërisht ky kozmopolitizëm kaq fanatik është, nga ana tjetër, në të njëjtën kohë çuditërisht edhe i kufizuar, deri në një pikë të tillë sa që krejt Shtetet e Bashkuara tërësohen me një “Hotel Oksidental”; gati të gjithë punonjësit janë emigrantë të gjeneratës së parë, por, edhe emigrantë të rinj, veçse ekskluzivisht evropianë dhe që të gjithë nga Evropa ... e Kafkës!

Për këtë arsye, pra, jo vetëm që “Amerika” e Kafkës paraqitet më mitike se reale, po bash nga miti, vetë ai nxjerr dhe ndërton një model që është projektimi në vija të trasha i Evropës në fushën e “mundësive të pakufizuara”.

Natyrisht që një model i tillë zë vend edhe në disa aspekte të realitetit shoqëror. Bie fjala, në kapitullin II flitet për një manifestim të punëtorëve, në kapitullin IV, gjithashtu, përshkruhet një grevë e punëtorëve të ndërtimit. Për Karlin dhe shokët e tij papunësia bëhet një obsesion, një ankth gati i përhershëm, ndërsa hoteli “Oksidental” është paradigma, simboli, shprehja e gjigantizmit industrial, që dënon punëtorët të kryejnë detyra të ndara në mënyra të pakuptueshme, të kota dhe me ritme rraskapitëse. Edhe tregimi patetik i Terezës për vdekjen e nënës së saj, ju bën t’ju dalin lot nga sytë. Megjithëkëtë, a mund të pretendojmë që romani i Kafkës ka synuar një kritikë socialiste për kapitalizmin amerikan? Po të përjashtonim fushatën plot

³ Melting pot – vend apo krahinë, ku emigrantët e racave të ndryshme janë asimiluar.

zhurmë elektorale, në të cilën asiston edhe Karli nga lartësia e ballkonit të Bruneldës, në të gjithë romanin nuk gjen asgjë specifike amerikane; edhe fati i Terezës dhe nënës së saj mund të themi haptas se është frymëzuar nga Dikensi. Aspektet e tjera të botës së punës nuk janë veçse zmadhimi i asaj që kishte njohur Kafka në Pragë që në vitin 1907, në cilësinë si jurist, nëpunës në një zyrë asistence të punëtorëve. Për të konkluduar mbi faktin nëse “*I zhdukuri*” mund të quhet edhe roman *social*, siç është pretenduar nganjëherë, çështja na shpie sigurisht në udhën e fatit të heroit dhe në kuptimin që merr “zhdukja”.

Cila zhdukje?

Gjashtë kapitujt e parë u redaktuan në vjeshtë të vitit 1912. Tani Kafka vendos përfundimisht titujt dhe i kërkon Feliksit në një letër, më 11 nëntor të po atij viti, që ai t’i “ruajë” ata, të mos i ndërrojë. Fati i adoleshentit në libër ndjek një lakore si dhëmbëzimet e sharrës. Çdo fatkeqësi, çdo disfatë, e tërhoqi atë, duke e rrëzuar diçka më poshtë nga ç’kishte qenë më parë; secila prej tyre vjen si pasojë e një gabimi të bërë pa dashje dhe të padjallëzuar. Prindërit e përzënë nga shtëpia Karl Rosmanin, ngaqë ai e lë veten të përdhunohet nga shërbëtorja e shtëpisë. Kjo e fundit lajmëron me letër një ungj të tij në Amerikë, njeri shumë i pasur, i cili e pranon me gëzim djaloshin fatkeq, që befas e sheh veten në kulmin e luksit dhe si trashëgimtar të mundshëm të një pasurie shumë të madhe. Po për një gabim tjetër krejt të parëndësishëm, të cilin as që mund ta paramendonte, pra, për shkak se pranoi një ftesë mirësjelljeje, që zemëroi për çudi “tycoon-in”⁴, aty nga mbarimi i kapitullit III, Karli zbohët përsëri dhe gjendet i hedhur në rrugë të madhe. Më pas bëhet shkak një keqdashje dhe budallallëku i njerëzve, si dhe përkujdesjet

⁴ Tycoon – industrialisti më i pasur e më i fuqishëm (fjalë anglisht).

prindërore të një gruaje, që ta shohim Karlin, në kapitullin V, në një strehëz të re, pranë ashensorit të vet, madje këtu ai ëndërron edhe që të ngrihet përsëri në shoqëri. Po mëshira e Karlit për plogështinë e një shoku të vjetër të rrugës, për pijanecin Robinson, e komprometon në mënyrë të pandreqshme, deri në atë pikë sa e zbojnë për të tretën herë. Këtë radhë ai humbet edhe valixhen e plaçkat e veta, fotografinë e prindërve, madje edhe xhaketën.

Në fundin e kapitullit VI, ky është edhe mendimi i Kafkës, kemi ardhur në gjysmën e romanit të projektuar prej tij. Që prej nëntorit 1912 e deri në janar të vitit 1913 Kafka redaktoi pjesën kryesore që flet për qëndrimin e Karlit te Brunelda, domethënë kapitullin VI, VII, si edhe pjesën më të madhe të kapitullit VIII. Dy kapitujt e parë të cituar lidhen me njëri-tjetrin dhe nuk kanë titull. Me sa duket, vetëm më vonë, deri në vitin 1915, Kafka duhet të ketë përfunduar skenën e ngrënies së mëngjesit te Brunelda, pastaj ka redaktuar dy fragmentet që në këtë libër përbëjnë kapitujt IX dhe X. Për Franc Kafkën kjo ka qenë një kohë e një veprimtarie letrare tepër të ngjeshur; megjithatë, asnjëherë nuk kam qenë i mendimit se ai i është kushtuar ekskluzivisht veprës “*I zhdukuri*”. Pareshtur ai ka punuar paralelisht edhe me vepra të tjera: në fillim shkruan “*Verdiktin*”, në fund “*Procesin*”. Sakaq “*I zhdukuri*” zhduket. Po përse?

Për pjesën e dytë të romanit, nisur nga pamja e jashtme në tërësi, nuk mund të flasim për gjëra shumë të sigurta. Pikësëpari na duket se skema e intrigës së mëparshme pëson ndryshime, madje përmbysset: i zburar për fatin e tij të keq tri herë (nga familja, nga ungji dhe nga hoteli “Oksidental”) Karli për çudi gjendet si një i burgosur me forcë në mikrokozmosin mbytës të Bruneldës. Megjithatë edhe në brendësinë e këtij mjedisi të katërt mund të vihet re që ai bie në një shkallë akoma më të ulët edhe një herë; në fragmentin ku përshkruhet mbartja e Bruneldës (kapitulli IX) Karli gjendet i vetëm pranë saj dhe duket sikur tashmë është

ndërmjetësi (kodoshi) dhe njëkohësisht shërbëtori i saj. Në Klejton (kapitulli X) punësimi i fundit i shkakton akoma më shumë turp, saqë tashmë preferon të ndryshojë identitetin e vetes dhe të quhet me një emër tjetër, *Negro*. Po teatri i Oklahomas a do t'i sjellë ndonjë farë shpëtimi, të themi një shërbim definitiv? Kjo çështje i ka shqetësuar shumë komentatorët për arsye se është mjaft e vështirë të përcaktohet në mënyrë të qartë.

Sikurse edhe në rastin e “*Kështjellës*”, Brodi pohon se po formësohej “një fund me pajtim”. Gjithnjë me “terma enigmatike”, Kafka do t'i tregonte atij “*që heroi i tij do të gjente në këtë teatër pothuaj të pakufishëm, si në një parajsë të mahnitshme, një profesion, lirinë, sigurinë, madje edhe prindërit, edhe vendin e vet*”. Një dëshmi e tillë nuk duhet hedhur poshtë; ky pretendim është shfrytëzuar gjerësisht dhe është kërkuar nëpër interpretimet me frymëzim fetar që janë vënë në mbarim (?) dhe në krejt romanin. Pra, kjo dëshmi mbetet, sado që edhe nga vetë Kafka kundërshtohet, një herë tjetër, me forcë; është fjala për atë që autori shkruan në ditarin e vet, kur krahason dy heronjtë e romaneve “*Procesi*” dhe “*I zhdukuri*”: “Rosmani dhe K., i padjallëzuari dhe fajtori, që të dy përfundimisht të dënuar me vdekje pa asnjë dallim, i padjallëzuari me një dorë më të lehtë, më tepër i skartuar sesa i mundur”. (30 shtator 1915).

Kjo kontradiktë, në nivelin e përmbajtjes, është e pakapërcyeshme. Mos vallë shpreh një hezitim? Apo është fjala për një dilemë, zgjidhja e së cilës, nëse na lejohet të shprehemi kështu, është braktisja e këtij projekt-romani, apo, së paku, mospërfundimi i tekstit të tij? Le të shënojmë më tej se kësaj kontradikte, që i përket thelbit të përfundimit, i përgjigjet, gjithashtu, një lloj *aporie* (vështirësi logjike, pa zgjidhje) në rrjedhën narrative: në çfarë mënyre mund të shkruhet “zhdukja” e një personazhi, me të cilin gjatë gjithë tekstit ne ndajmë bashkë perspektivën?

Si mund të humbasim gjurmët e heroit? Si mund ta bëjmë

atë të zhduket? Projekti, siç del nga titulli, e kërkonte, ndërsa perspektiva e zgjedhur e pengonte. Në kushte të tilla është vetë romani që mund të humbasë nëpër rërë dhe të zhduket.

Cili Kafka?

Ndoshta ky roman i pambaruar ishte nisur për të mos u mbaruar. Kafka largohet nga kantieri i këtij romani për të çelur kantierin e “Procesit”, të cilin po ashtu do ta braktisë pa e mbaruar, po jo pa shkruar përfundimin. Mbetet të themi se kjo vepër është e lidhur shumë ngushtë me sjelljet e vetë autorit (le të kujtojmë këtu edhe që Kafka ndryshon disa herë emrat e heronjve); gjë që na e vështirëson goxha mundësinë për të parë, shohim veçse njëfarë skicimi të flakur tej me të drejtë, i cili është i zhveshur nga domethëniet e thella.

Është e vërtetë se i riu Karl Rosman i ngjet më shumë Artur Gordon Pimit ose David Koperfildit se sa Jozef K. E vërtetë është, gjithashtu, se mbiemri “kafkajan” (në kuptimin banal, po të drejtë) nuk gjen askund shtrirje në universin mitik, që skematizohet si model nën emrin “Amerika”. E vërtetë është akoma më tej që elementi komik, siç shkruan Klod David, nuk është “humori i zi i “Metamorfozës” apo i “Procesit”: në vend që ta theksojë tmerrin, urrejtjen e thellë, Kafka e fsheh ose e mënjanon atë”. Vallë të jetë e tillë fillesa prej kafke e Kafkës?

Disa imazhe e disa tema megjithatë janë “në vendin e tyre”. Dhe këto nuk janë pak thelbësore. Kështu, që në faqen e parë, Karlit, i cili ka humbur çadrën dhe në mënyrë krejt të natyrshme zbret ta kërkojë poshtë, për disa çaste i duket vetja i humbur në një labirint të ndërlikuar korridoresh dhe ndërurash. Kjo është një hollësi, një frazë, po tashmë s’ka asnjë dyshim se në imazhe të tilla është tamam Kafka. E tillë është edhe tema që vjen nga gabimet e padjallëzuara, që ritmojnë gjithë intrigën, temë që

është në zemër të të gjitha teksteve të Kafkës. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për urrejtjen ndaj seksualitetit, që në të gjithë rrëfimin të del ngado përpara, duke filluar që nga gabimi i parë i Karlit e duke vazhduar te mishrat e papërmbajtura të Bruneldës trashaluke. Pastaj, në mënyrë më të përgjithshme, udhëtimi dëshpërues i Karlit (nuk e dimë nëse po përdorim termin e saktë) a nuk është i njëjtë me atë të të gjitha personazheve të veprave më të plota e më të përmendura?

Së fundi, duhet të themi se, duke dalë nga një barokizëm simbolist që takohet aty-këtu ende, si për shembull përshkrimi i një beteje, shkrimtari Kafka angazhohet me këtë roman të parë të pambaruar të ecë nëpër rrugët e reja origjinale që do të ndjekë këtej e tutje: ato të një stili të zhveshur, linear, pa arabeska, ato të një psikologjie që nuk përfill psikologjizmin; angazhohet, gjithashtu, të fitojë një lloj zemërdëlirësie të natyrës së Robert Valserit, të cilën, nga ana e vet, e përshëndeti me mendjemprehtësi (kur u botua “Makinisti”, kapitulli I) një novator tjetër i madh i këtij shekulli, Robert Myzil.

Duke zëvendësuar flakën e Lirisë me shpatën e Drejtësisë, mund të mendohet se Kafka ka dashur të nënkuptojë se çfarë gjëje të tmerrshme mund të mbartë Liria, në të cilën bëhen të pakufishme si mundësitë e ngjitjes lart, ashtu edhe ato të dështimit. Po, nga ana tjetër, ky zëvendësim dashakeqës dhe i thellë, me të cilin fillon rrëfimi, mund të merret edhe në kuptimin letrar, si një njoftim për *hyrjen e një mprehtësie të re* në artin e romanit, por edhe kjo jo më pak e *tmerrshme*.

BERNARD LORTOLARI

I

MAKINISTI

Kur djaloshi Karl Rosman, në një moshë gjashtëmbëdhjetë-vjeçare, që po detyrohej të mërgonte në Amerikë, i dëbuar prej prindërve, për arsye se ishte mashtruar nga shërbëtorja, me të cilën pati marrëdhënie seksuale, madje kishte lindur edhe një fëmijë, hyri në portin e Nju Jorkut mbi një anije, që prej kohësh kishte nisur të ngadalësonte ecjen, Statuja e Lirisë, të cilën po e vështronte prej disa çastesh, iu duk befasi e ndriçuar nga një diell më i gjallë. Në krah ajo kishte një shpatë, që atë çast i dukej se po vringëllinte, ndërsa mburojën ia përshkonte një flad i furishëm.

– Sa e lartë qenka! – tha ai.

Nuk kishte në mendje të largohej këtë çast, megjithatë vala e bagazhmbajtësve, të cilët kalonin pranë tij, e shtynte herë pas here, duke e bërë të afrohej te parmakët e anijes.

Burri në moshë të re, me të cilin ishte njohur gjatë udhëtimit, duke ecur pranë tij, i tha:

– Hë, ç’thua, nuk ke qejf të zbresësh në tokë?

– Po, gati jam, – tha Karli duke sajuar një buzëqeshje të gjallë.

Dhe si me mburrje, për të treguar se ishte një djalë i fortë, e ngriti në sup valixhen e vet. Pastaj, i hutuar, duke vështruar atë

burrë që i largohej për herë e më shumë nga sytë së toku me të tjerët duke tundur bastunin, shtangu për një çast dhe u kujtua se brenda anijes, në një qoshe, kishte harruar çadrën. Vrapoi që t'i kërkonte mikut t'i mbante pak valixhen, ndonëse këtij të fundit nuk i erdhi edhe aq mirë nga ky propozim, studioi vendin rreth e qark që të mos ngatërrohej kur të kthehej dhe u nis vrik poshtë anijes. Sapo zbriti shkallët ndjeu njëfarë zhgënjimi, ngaqë një shteg që të shkurtonte mjaft udhë tashmë ishte i mbyllur; pa dyshim kjo i detyrohej zbarkimit të plotë të pasagjerëve; me vështirësi kërkoi dhe gjeti një tjetër shteg, që kalonte nëpër disa shkallë që rrinin njëra pas tjetrës gati në pambarim e që i kishin skajet nëpër korridore gjarpëruese; u gjend pastaj pranë një kabine të shkretuar, ku priste një tryezë pune pa njeri, për një çast iu duk se në këtë rrugë kishte kaluar nja dy herë, madje i shoqëruar me të tjerë. Fare i hutuar nga vetmia, duke mos parë asnjëri të kalonte këtu, nisi të përfytyrojë se sipër tij ishin duke kaluar mijëra këmbë, pastaj diku më larg dëgjoji si të ishte një gulçimë kërcitjen e fundit të pjesëve metalike që po pushonin së punuari; pa e zgjatur më tej trokiti në të parën portë që i zunë sytë.

– Hyr, është hapur! – foli një zë nga brenda.

Karli, tashmë i kënaqur që dëgjoji një zë njerëzor, hapi derën:

– Pse troket si i marrë në derë? – iu drejtua një burrë i gjatë dhe i dhjamosur, që i hodhi një çast një vështrim të shpejtë djaloshit Karl.

Diku sipër tavanit të kësaj kabine të vjetër duhej të ishte një baxho, nga e cila zbriste një dritë e zbehtë; në kabinë ndodhej një shtrat, një stendë afishimi për lajmërimet, një karrige. Në të rrinte burri që foli. Çdo gjë kishte pamjen si të ishte ndrydhur brenda një gardërobe.

– Kam humbur rrugën, – tha Karli, – nuk isha i vëmendshëm gjatë udhëtimit. Qenka një vapor i madh.

– Ashtu është, – tha burri pak me mburrje, – vaporin ynë është

i madh.

Njeriu i kabinës po përpiquej të ndreqte bravën e një valixheje të vogël, me të dyja duart hapte e mbyllte pa pushim kapakun, duke i vënë veshin kërcitjes që bënte brava gjatë mbylljes.

– Hyr, pra, brenda, pse rri në derë?

– Nuk ju bezdis? – tha Karli.

– Bah! Ç’është ajo fjalë!

– Mos jeni gjerman?

Karli dëshironte të sigurohej, kishte dëgjuar shpesh të flitej rreth rreziqeve që u kanoseshin të huajve të porsaardhur në Amerikë nga të huaj të tjerë, emigrantë ose jo, sidomos nga irlandezët.

– Është e vërtetë, – tha burri.

Karli përsëri po ngurronte. Tani burrit nuk iu durua më, hapi me duart e veta derën, tërhoqi brenda Karlin dhe pastaj e mbylli prapë. Më pas, duke iu vënë edhe një herë punës mbi valixhe, tha:

– Nuk duroj dot të më shohin nga korridori se ç’bëj në kabinë. Çdo njeri që shkon këtej fut hundët këtu dhe do të shikojë se çfarë bëj.

– Po tani nuk ka njeri në korridor, – tha Karli, që iu duk sikur gjendej pak si keq aty në atë cep të shtratit këtë çast.

– Është e vërtetë, tashti nuk ka njeri! – tha burri.

“Ky flet sikur të mos jetë fjala për këtë çast, mendoj Karli. Nuk qenka e thjeshtë të merresh vesh me këtë njeri.”

– Shtriu në shtrat, ke boll vend në të, – i tha më pas burri.

Desh nuk desh Karli u rehatua në shtrat, më pas nisi t’ia plaste së qeshurës, ngaqë po përpiquej të ngrihej prej tij dhe nuk po ia dilte.

– Sapo e kam ndrequr dreqin, – shfryu burri.

– Oh, Zot i madh! Harrova fare punën e valixhes.

– Ku e ke lënë?

– Lart, mbi urë. Ia kam lënë një miku të ma ruajë. Prit, si

quhet?

Dhe nga xhepi i fshehtë që i kishte sajuar e ëma brenda astarit të xhakëtës enkas për këtë udhëtim, nxori një kartë-vizitë:

– Batërbaum, Franc Batërbaum.

– Dhe të duhet tashti domosdo kjo valixhe?

– Natyrisht!

– Po si ia paske besuar valixhen një të panjohuri?

– Ngaqë kisha harruar këtu poshtë çadrën, duhej të nxitohesha, nuk dëshiroja të lëvizja me gjithë valixhe. Po, me sa duket, e humba edhe valixhen tashmë.

– Je vetëm, nuk ke njeri që të shoqëron?

– Po, fare vetëm.

Për një hop Karli mendoi se me këtë njeri mund të merrej vesh mirë. E ku të gjente tani për tani ndonjë njeri më të përshtatshëm për ta ndihmuar?!

– E mbi të gjitha, – tha ai, – ja ku humba tani edhe valixhen. Në djall të kishte shkuar çadra përpara saj.

Burri u ul mbi një karrige sikur të donte të tregonte kështu se shqetësimi i Karlit i interesonte.

– Megjithatë mendja më thotë se valixhja mund edhe të mos ketë humbur, – vazhdoi Karli.

– Mund të të shpëtojë vetëm besimi që ke, – tha burri teksa karashtiste flokët e tij të zinj. – Morali ndryshon sipas porteve. Në Hamburg, për shembull, Batërbaumi yt do të ta kishte ruajtur valixhen, po në këtë port, vë bast se nuk ke për t'ia parë më gjurmët as njërës, as tjetrës.

– Atëherë po ngrihem e po shkoj lart sa më parë, – tha Karli, duke vërtitur sytë për të gjetur derën e daljes.

– Rri këtu, – tha burri, duke i dhënë një të shtyrë në kraharor; të themi hapur, si gjigant që ishte, shtytja që i dha iu duk Karlit brutale.

– Përse kërkon që të rri këtu? – shtoi gjithë hutim Karli.

– Ngaqë nuk ka asnjë kuptim, – tha burri. –Ja, edhe pak dhe

po nisemi bashkë. Ose valixhen ta kanë vjedhur dhe nuk ke se çfarë të bësh, do të ishte e kotë që ta kërkoje, ose dikush mund ta ketë lënë në ndonjë qoshe, ndaj kur të gjithë do të jenë larguar nga anija, ne mund ta gjejmë. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për çadrën.

– E njeh mirë çdo skutë të vaborit? – pyeti me mosbesim Karli.

Pati përshtypjen se diçka çalonte në këtë mes, po, nga ana tjetër, mendimi se ai mund t'i gjente plaçkat e veta vetëm pasi të qe zbrazur anija nga njerëzit e qetësoi disi dhe sikur e bindi.

– Dëgjo këtu, – tha burri, – unë jam makinisti i kaldajave të vaborit.

– Jeni makinisti i anijes? – thirri Karli me gëzim, sikur të mos e kishte shpresuar më parë këtë gjë; tani u mbështet mbi bërryl për ta studiuar më nga afër njeriun që i thoshte se ishte makinisti i kësaj anijeje. – Tani po më kujtohet, karshi me kabinën ku rrija me një shokun tim sllovak, dukej një dritare e vogël, e rumbullakët, nga e cila dallohej salla e makinerisë.

– Po, atje punoj, – tha makinisti.

– Më kanë pëlqyer gjithnjë gjërat që lidhen me teknikën, – shtoi Karli, duke përsiatur në mend idenë e vet, – dhe ndoshta në të ardhmen do të bëhesha inxhinier, nëse nuk do të detyroheshja të vija këtu, në Amerikë.

– E përse u largove, atëherë, nga vendi yt?

– Ah, – tha Karli dhe bëri një gjest me dorë sikur të donte të fshinte gjithë historinë e shkuar, pastaj nënqeshi si të kërkonte mëshirën e burrit.

– Ndoshta ke pasur arsyet e tua, – tha makinisti.

Nuk u kuptua mirë nga kjo frazë nëse makinisti kishte qëllim të zgjeronte më tej afinitetin apo dëshironte t'i jepte fund bisedës.

– Tashti edhe unë mund të bëhem makinist, – tha Karli, – prindërit ma kanë hequr krejt fillin, ata as nuk e çajnë më kokën